



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë
Kundër Korrupsionit
Janar-Qershor

Prishtinë, 2012

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Prokuroria e Kosovës	5
Sistemi Gjyqësor	7
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	7
Policia e Kosovës	8
Agjencia Kundër Korrupsion	9
Qeveria e Kosovës	10
Kuvendi i Kosovës	11
Falënderime	12
Rreth FOL-it	12

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

VV - Lëvizja Vetëvendosje

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PK - Policia e Kosovës

SKK PV - Strategjia Kundër Korrupsion dhe Plani i Veprimit

UNDP - United Nations Development Programme

Përmbledhje Ekzekutive

Prokuroritë e rregullta publike (të qarkut dhe ato komunale) kanë pranuar në punë gjithsej 345 lëndë; kanë hedhur poshtë 140 raste të kallëzimeve penale; kanë ngritur 98 akte akuzuese (73 propozim-aktakuza dhe 25 aktakuza), si dhe kanë pushuar hetimet ndaj 24 rasteve. Ndërkaq, numri i përgjithshëm i lëndëve që janë në proces të shqyrtimit është 922.

Bazuar në aktet akuzuese të prokurorive të qarkut dhe atyre komunale rezulton se shtrirja gjeografike e korrupsionit është më e madhe në Prishtinë - me 50 akte akuzuese (33 propozim-aktakuza dhe 17 aktakuza); pason Peja me 19 akte akuzuese (17 propozim-aktakuza dhe 2 aktakuza); Gjilani me 10 (9 propozim aktakuza dhe 1 aktakuzë); Prizreni me 7 (6 propozim aktakuza dhe 1 aktakuzë); Ferizaj me 8 (7 propozim akt-akuza dhe 1 aktakuzë), si dhe Gjakova me 4 (1 propozim aktakuzë dhe 3 aktakuza). Ndërkaq, prokuroria e qarkut dhe ajo komunale e Mitrovicës nuk ka ngritur as edhe një akt akuzues të vetëm.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk ka ngritur as edhe një propozim akuzë apo aktakuzë të vetme. Gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë 5 lëndë, 88 lëndë janë në proces të shqyrtimit, kurse është hedhur kallëzim penal ndaj 4 personave.

Gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë trashëguar nga vitet paraprake 175 lëndë: 120 nga kategoria Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 35 nga kategoria Marrja e Ryshfetit dhe 20 nga kategoria Dhënia e Ryshfetit. Gjatë gjashtë mujorit të parë janë pranuar në punë gjithsej 89 lëndë: 47 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 22 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 20 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 218: 148 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 47 në Marrje të Ryshfetit dhe 23 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Gjykatat komunale kanë zgjidhur gjithsej 64 lëndë: 36 në kuadër të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, 10 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 18 në Dhënie të Ryshfetit. Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese kanë mbetur gjithsej 187 lëndë të pazgjidhura: 126 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 40 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 21 në Dhënie të Ryshfetit.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), rezulton se Policia e Kosovës në gjashtë mujorin e parë të 2012 ka hetuar në total 95 raste dhe ka arrestuar gjithsej 28 zyrtarë të ndryshëm publikë. Përveç kësaj, Policia ka dërguar 69 raste në Prokurori me kryerës të njohur; 1 rast me kryerës të panjohur (N/N); dhe 9 raste me raport të veçantë të prokurorit.

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka qenë kryesisht e fokusuar në tre aktivitete në luftë kundër korrupsionit. Ka publikuar Raportin Vjetor të punës së saj një vjeçare dhe ka përmbyllur procesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Ajo po ashtu ka publikuar edhe Listën prej pesëmbëdhjetë zyrtarëve të lartë publik, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të AKK-së për t'iu shmangur konfliktit të interesit në të cilën ndodheshin duke ushtruar paralelisht funksionin publik dhe duke udhëhequr biznese private.

Qeveria e Kosovës nuk ka demonstruar vullnet për luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e tij në institucionet publike. Nga 180 vendime sa ka miratuar gjithsej, vetëm 4 sosh kanë qenë në “luftë” kundër korrupsionit: a) miratimi i Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2012-2016; b) themelimi i Komitetit Ekzekutiv “Qeverisja” (i cili do të përqendrohet në hartimin e politikave anti-korrupsion); c) miratimi i kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsion për shkarkimin e z. Elez Hajdaraj, anëtar i Bordit të Drejtorëve të “Hidrodrinit”, SH.A. Pejë dhe d) aprovimi i kërkesës tjetër të AKK-së për shkarkimin e z. Ismajl Jonuzi, anëtar i Bordit të Drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues dhe demokratik në vend, nuk është treguar aspak produktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Nga 29 seanca plenare sa ka mbajtur gjithsej, vetëm në dy prej tyre është diskutuar për luftën “kundër” korrupsion: a) Strategjinë Kundër Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2012-2016 dhe b) Raporti Vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsion (2011). Pa marrë parasysh diskutimet e bëra në këto dy seanca, ato nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi në uljen e nivelit të lartë të korrupsionit në vend.

Prokuroria e Kosovës¹

Prokuroritë e rregullta publike (të qarkut dhe ato komunale) kanë pranuar në punë gjithsej 345 lëndë; kanë hedhur poshtë 140 raste të kallëzimeve penale; kanë ngritur 98 akte akuzuese (73 propozim-akuza dhe 25 aktakuza), si dhe kanë pushuar hetimet ndaj 24 rasteve.

Ndërkaq, numri i përgjithshëm i lëndëve që janë në proces të shqyrtimit është 922.



Nëse i ndajmë sipas shtrirjes gjeografike shohim se korrupsioni është përqendruar si në vijim:

Prishtinë (Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë gjithsej 207 lëndë; 487 lëndë kanë qenë në proces të shqyrtimit; 93 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; janë ngritur 50 akte akuzuese (33 propozim aktakuza dhe 17 aktakuza) dhe në 8 raste tjera janë pushuar hetimet.

Pejë (Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale) - gjatë periudhës raportuese

ka pranuar në punë 34 lëndë; 87 lëndë kanë qenë në proces të shqyrtimit; 12 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; janë ngritur 19 akte akuzuese (17 propozim aktakuza dhe 2 aktakuza) dhe në 10 raste janë pushuar hetimet.

Gjilan (Prokuroria e Qarkut dhe Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë gjithsej 24 lëndë; 42 lëndë kanë qenë në proces shqyrtimi; 5 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; janë ngritur 10 akte akuzuese (9

propozim aktakuza dhe 1 aktakuzë) dhe në 2 raste janë pushuar hetimet.

Prizreni (Prokuroria e Qarkut dhe Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në


punë 44 lëndë; 138 kanë qenë në proces shqyrtimi; 21 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; janë ngritur 7 akte akuzuese (6 propozim aktakuza dhe 1 aktakuzë) dhe në 2 raste është pushuar hetimi.

Ferizaj (Prokuroria e Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë 10 lëndë; 23 kanë qenë në proces shqyrtimi; 3 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; si dhe janë ngritur 8 akte akuzuese (7 propozim aktakuza dhe 1 aktakuzë).

¹ Në kuadër të Prokurorisë i analizojmë të gjitha veprat që sanksionohen me kapitullin XXIX të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Gjakovë (Prokuroria Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë 10 lëndë; 12 kanë qenë në proces të shqyrtimit; 4 raste të kallëzimeve penale janë hedhur poshtë; si dhe janë ngritur 4

akuzues të vetëm. Gjatë periudhës sa ne po raportojmë ka pranuar në punë 5 raste, 88 lëndë janë në proces të shqyrtimit, ndërkaq është hedhur kallëzim penal ndaj 4 personave.



akte akuzuese (1 propozim aktakuzë dhe 3 aktakuza); si dhe në një rast është pushuar hetimi.

Mitrovicë (Prokuroria e Qarkut dhe Komunale) - gjatë periudhës raportuese ka pranuar në punë 10 lëndë; 45 kanë qenë në proces shqyrtimi; ndërkaq nuk ka ngritur as edhe një akt akuzues të vetëm.

Përkundër kompetencave plotësuese² që Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka në fushën e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe pritjeve të mëdha që qytetarët e Kosovës kanë nga Task Forca Anti Korrupsion³, ajo gjatë këtij intervali kohorë nuk ka ngritur as edhe një akt

Sistemi Gjyqësor Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

² Më gjerësisht shih nenin 9, Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

³ Task-Forca Antikorrupsion vepron përbrenda Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe përbëhet nga gjithsej 8 prokurorë: 5 vendorë dhe 3 të tjerë nga radhët e EULEX-it.


Këshilli Gjyqësor i Kosovës⁴ Gjykatat e rregullta komunale të Kosovës kanë trashëguar nga vitet paraprake 175 lëndë: 120 nga kategoria Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 35 nga kategoria Marrja e Ryshfetit dhe 20 nga kategoria Dhënia e Ryshfetit.

Gjatë gjashtë mujorit të parë janë pranuar në punë gjithsej 89 lëndë: 47 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 22 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 20 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Ndërkaq si lëndë në punë që janë në proces të shqyrtimit janë gjithsej 218: 148 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 47 në Marrje të Ryshfetit dhe 23 në kategorinë Dhënie e Ryshfetit. Gjykatat komunale kanë zgjidhur gjithsej 64 lëndë: 36 në kuadër të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, 10 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 18 në Dhënie të Ryshfetit.

Ndërkaq, në fund të periudhës raportuese kanë mbetur gjithsej 187 lëndë të


pazgjidhura: 126 në kategorinë Shpërdorim i Pozitës Zyrtare, 40 në kategorinë Marrje e Ryshfetit dhe 21 në

Dhënie të Ryshfetit.



Policia e Kosovës

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK), rezulton se Policia e Kosovës në gjashtë mujorin e parë të 2012 ka hetuar në total 95 raste dhe ka arrestuar gjithsej 28 zyrtarë të ndryshëm



publikë. Përveç kësaj, Policia ka dërguar 69 raste në Prokurori me kryerës të njohur; 1 rast me kryerës të panjohur (N/N); dhe 9 raste me raport të veçantë të prokurorit.

⁴ Në kuadër të monitorimit tonë të Gjykatave të rregullta të Republikës së Kosovës I analizojmë vetëm tri kategoritë kryesore që kanë të bëjnë me veprat penale me natyrë korruptive; Shpërdorimi i pozitës zyrtare, marrja e rryshfetit, dhënia e rryshfetit.

Agjencia Kundër Korrupsionit

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) në kuadër të gjashtë mujorit të parë të viti 2012 ka qenë e fokusuar në publikimin e raportit ku ka pasqyruar punën e saj një vjeçare. Në këtë raport AKK-ja ka ofruar statistika përmes së cilave synon të dëshmoj përpjekjet e saja në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Raporti tregon që AKK-ja gjatë viti 2011 ka iniciuar hetimin paraprak për 160 raste të dyshuara për korrupsion⁵. Pasi që AKK-ja ka zhvilluar procedurën e hetimit paraprak për këto raste, ajo për 39 raste ka gjetur elemente të ndryshme për veprime korruptive dhe këto raste i ka përcjellë në Prokuroritë kompetente të Kosovës dhe EULEX-it, si dhe organet policore kompetente dhe Policinë e EULEX-it për procedim të mëtutjeshëm. Nga këto 39 raste, 5 prej tyre AKK-ja ka dyshuar në shkelje administrative dhe këto raste i përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore. Nga shifra prej 39 rasteve që AKK-ja i ka përcjell në organet kompetente, ajo ka denoncuar 121 person si të dyshuar të jenë përfshirë në veprime penale⁶.

Që nga funksionalizimi i AKK-së, kjo e fundit ka proceduar në organet kompetente 240 raste të ndryshme si të dyshuara për veprime korruptive. Nga kjo shifër AKK-ja ka denoncuar 649 persona si të dyshuar për përfshirje në afera korruptive, por vlen të theksohet që për 20 raste, AKK-ja nuk ka arritur që të identifikoj personat përgjegjës dhe kjo

mund ta çoj numrin në 700 të personave të dyshuar si të përfshirë në veprime korruptive. Sipas AKK-së, vlera totale e dëmit që është shkaktuar nga veprimet e mundshme korruptive, për të cilat AKK-ja gjatë periudhës raportuese i ka proceduar 39 Kallëzime Penale dhe informata, në Institucionet kompetente, supozohet të jetë mbi 10 milion e 300 mijë Euro.

AKK-ja gjatë kësaj periudhe raportuese ka përmbyllur edhe procesin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publik. Këtë vit numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë qenë të obliguar që ta deklarojnë pasurinë ka qenë 3657. Nga ky numër, obligimin ligjor e kanë përmbyllur 3354 ose 91.71%, ndërsa numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 261 zyrtarë të lartë publikë. Prej tyre, 6 zyrtar të lartë kanë ofruar tek AKK-ja dëshmi që gjenden jashtë vendit apo janë të sëmurë, kurse sipas AKK-së numri i atyre të cilët e kanë deklaruar pasurinë pas afatit ligjor është gjithsej 36. Por, bazuar në nenin 17 të ligjit për Deklarim të Pasurisë⁷, AKK-ja ka bërë të ditur se i ka adresuar lëndët e të gjithë atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin ligjor tek gjykatat për kundër vajtje. Këto të fundit kanë filluar shqiptimin e dënimeve me gjobë për mos respektuesit e afatit ligjorë për deklarimin e pasurisë.

Ajo po ashtu ka publikuar edhe listën prej pesëmbëdhjetë zyrtarëve të lartë publik, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të Agjencisë Kundër Korrupsionit për t'iu shmangur konfliktit të interesit

⁵ Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), Raporti vjetor 2011, faqe 6-7. http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_Punes_2011_i_AKK-se-VP_si%20pdf.pdf


⁶ Po aty, faqe 8.

⁷ Gazeta Zyrtare, Ligji për Deklarimin e Pasurisë (04/L-050) [https://gazetazyrtare.rksgov.net/Documents/Ligji%20per%20deklarimin%20e%20pasurise%20se%20zyrtarve%20te%20larte%20\(shqip\).pdf](https://gazetazyrtare.rksgov.net/Documents/Ligji%20per%20deklarimin%20e%20pasurise%20se%20zyrtarve%20te%20larte%20(shqip).pdf)

në të cilën ndodheshin duke e ushtruar kështu paralelisht funksionin publik dhe duke udhëhequr biznese private njëkohësisht, gjë e cila ndalohej me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.⁸

Qeveria e Kosovës

Përkundër deklarimeve të Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, se “viti 2012 do të jetë vit i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar”⁹, Qeveria e Kosovës përgjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti nuk ka treguar vullnet në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në institucionet publike. Nga 180 vendime sa ka miratuar gjithsej, vetëm 4 sosh kanë qenë në “luftën” e korrupsionit.



Vendimi i parë i Qeverisë është ai i miratuar në Janar të këtij viti për Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsion 2012-2016¹⁰. Ky dokument është produkt i Agjencisë Kundër Korrupsion dhe i cili përmban politikat dhe masat konkrete kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet

përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.¹¹ Me gjithë përpjekjen e madhe të Qeverisë për ta përkthyer këtë Strategji si një hap të rëndësishëm në luftë kundër korrupsionit, prapëseprapë kjo strategji ka hasë në kritika të shumta nga shoqëria civile. Organizatat e ndryshme jo-qeveritare kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me procesin e hartimit dhe mos përfshirjen e rekomandimeve në hartimin e kësaj strategjie.¹²

Me vendimin e dytë të marrë në shkurt të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka themeluar komisionin Ekzekutiv “Qeverisja”. Në kuadër të fushëveprimit të këtij komisioni, do të përfshihen edhe Politikat Anti-Korrupsion dhe Gjyqësori.¹³

Me 1 shkurt 2012, Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsion për shkarkimin e z. Elez Hajdaraj, anëtar i Bordit të Drejtorëve të KUR “Hidrodrini”, SH.A. Pejë.¹⁴ Po me vendim të Qeverisë është miratuar edhe kërkesa tjetër e AKK-së për shkarkimin e z. Ismajl Jonuzi, anëtar i Bordit të Drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)¹⁵, pasi që të dy sipas kësaj Agjencie kanë paraqitur konflikt interesi.

Pavarësisht këtyre vendimeve, korrupsioni mbetet edhe më tutje në nivelet e tija më të larta. Është pikërisht niveli i tillë i korrupsionit që është duke ndikuar në uljen e besueshmërisë së qytetarëve në Ekzekutivin e vendit. Sipas

⁸ Më gjerësisht shih nenin 9; Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik; Kuvendi I Kosovës 31.08.2011

⁹<http://www.zeri.info/artikulli/1/1/41430/thaci-2012-vit-i-luftimit-te-korrupsionit/>

¹⁰ Qeveria e Kosovës, vendimi nr.01/56 (11.01.2012)

¹¹ Agjencia Kundër Korrupsionit, <http://www.akk-ks.org/?cid=1,17,410>

¹² Lëvizja FOL, Hulumtim Politikash: Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2009-2011; <http://levizjafol.org/al/publikimet>

¹³ Qeveria e Kosovës, vendimi nr.06/59 (01.02.2012)

¹⁴ Qeveria e Kosovës, vendimi nr.12/59 (01.02.2012)

¹⁵ Qeveria e Kosovës, vendimi nr.13/59 (01.02.2012)

Raportit Pulsi Publik, “niveli i kënaqshmërisë me punën e Qeverisë dhe Kryeministrit ka shënuar rënien më të madhe që nga viti 2007”. Sipas këtij studimi vetëm 21% e qytetarëve janë të kënaqur me punën e Qeverisë dhe rreth 24% të tyre janë të kënaqur me punën e Kryeministrit”.¹⁶

Kritika kundër Qeverisë ka pasur edhe nga subjektet opozitare. Sipas Lidhjes Demokratike të Kosovës “Qeveria Thaçi, përveç që nuk ka treguar vullnet për luftimin e këtyre dukurive, ka kontribuar në rritjen e tyre, sidomos në institucionet që do të duhej të ishin shembull i luftimit të dukurive negative”.¹⁷ Më e zëshme ka qenë Lëvizja Vetëvendosje, e cila madje ka kërkuar në vazhdimësi dorëheqjen e Qeverisë “Thaçi 2”.

Kuvendi i Kosovës


Kuvendi i Kosovës, si organi më i lartë përfaqësues dhe demokratik në vend, nuk është treguar aspak produktiv në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Nga 29 seanca plenare sa ka mbajtur gjithsej, vetëm në dy prej tyre është diskutuar për luftën “kundër” korrupsion: a) Strategjinë Kundër Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2012-2016 dhe b) Raporti Vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsion (2011).

Me datë 19 prill 2012, Kuvendi i Kosovës ka debatuar për Strategjinë Kundër Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2012-2016.¹⁸ Fillimisht, Strategjia është diskutuar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, i cili vepron në kuadër të Kuvendit të Kosovës. Megjithatë Strategjia nuk është rekomanduar nga komisioni të shkojë për votim në Kuvend, duke qenë se anëtarët e këtij Komisioni kanë votuar në mënyrë të barabartë: me 4 vota për dhe 4 vota kundër, prapëseprapë ajo ka shkuar në Kuvend.¹⁹

Në seancën e mbajtur, në të cilën është diskutuar për SKK dhe PV 2012-2016, në emër të grupit parlamentar të PDK-së Behar Selimi ka rekomanduar që strategjia të aprovohet në Kuvend. Përkundër kësaj deputetja nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka thënë se “kjo strategji nuk i përmbush objektivat kryesore për

Numri i seancave plenare të Kuvendit dhe i çështjeve të ngritura në fushën e antikorrupsionit Janar-Qershor 2012



luftimin e korrupsionit, së këndejmi dihet se si do të jetë vota e LDK-së për këtë

¹⁶ UNDP: Anketa e Pulsit Publik, Maj 2012, Prishtinë, faqe 2

¹⁷ Më gjerësisht shih <http://www.ldk-ks.eu/media/lajme/693>

¹⁸ Ky dokument përmban politikat dhe masat konkrete kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Më gjerësisht shih; <http://www.akk-ks.org/?cid=1,17,410>

¹⁹ Kuvendi i Kosovës; Komisioni për Legjislacion; http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/proc_2012_03_12_11_4_065_al.pdf

strategji”²⁰. Edhe më kritike është treguar deputetja nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, e cila ka pohuar se “strategjia kundër korrupsionit 2012-2016 tregon se si nuk luftohet korrupsioni”. Më tutje, ajo ka arsyetuar pozicionin e subjektit të saj duke thënë se “në këtë strategji nuk është bërë një hulumtim paraprak, i cili do të tregonte shkaqet, natyrën e korrupsionit dhe shkallën e nivelit të korrupsionit në Kosovë; plus asaj nuk është marrë asnjë rekomandim i shoqërisë civile për këtë strategji”.²¹ Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), deputeti Burim Ramadani ka deklaruar njashtu “se grupi parlamentar i AAK-së nuk do ta votojë këtë strategji, me arsyen se është një strategji së koti”.²²

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i Kuvendit e ka hedhur në votim Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsioni 2012-2016. Nga 68 deputet të pranishëm, 19 kanë votuar për, 39 kanë votuar kundër, 6 deputetë të tjerë kanë abstenuar, me ç’rast Strategjia nuk ka marrë miratimin e organit më të lartë përfaqësues dhe demokratik të vendit.

Më 11 maj të vitit 2012, Kuvendi ka diskutuar për Raportin e Punës të Agjencisë Kundër Korrupsion. Ky raport është prezantuar nga Armend Zemaj në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Pas disa diskutimeve, Raporti është hedhur në votim, e i cili me 48 vota pro, 8 kundër dhe 2 abstenime është miratuar nga parlamentarët e vendit.

Pavarësisht se Kuvendi ka diskutuar në këto dy seanca për korrupsionin, shikuar nga aspekti cilësor nuk është se kanë pasur ndonjë impakt në luftimin serioz të korrupsionit. Është pikërisht kjo qasje jo serioze e Kuvendit që ka ndikuar në uljen e kënaqshmërisë së qytetarëve të Kosovës me punën e Legjislativit. Sipas Anketës së realizuar nga UNDP, Pulsit Publik, ky nivel i kënaqshmërisë ka rënë për 8% nga nëntori i vitit të kaluar.²³

²⁰ Më gjerësisht shih;

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2012_04_19_10_4168_al.pdf, faqe 99

²¹ Më gjerësisht shih:

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2012_04_19_10_4168_al.pdf, faqe 99-100

²² Po aty

²³ UNDP: Anketa e Pulsit Publik, Maj 2012, Prishtinë, faqe 2

Falënderime

Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: www.monikorr.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakt:

Andrea Gropa 35, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org